

25341/6

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË TIRANË
Nr. 25341/6

VENDIM I GJYQTARIT TË VETËM

Sot, më datë 10 Korrik 2002, unë Anila Capo, gjyqtare pranë kësaj gjykate, pasi studjova kërkesën dhe dokumentacionin e paraqitur nga z. James Reiff në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të Shoqërisë PARTNERI SHQIPTAR NË MIKROKREDI SHA për depozitim të akteve të personit juridik,

KONSTATOVA SE:

Shoqëria anonime PARTNERI SHQIPTAR NË MIKROKREDI SHA është person juridik i së drejtës shqiptare i regjistruar me Vendimin Nr. 25341, datë 2 mars 2001 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, me seli në adresën Rruga "Gjin Bue Shpata", Nr. 7/1, Tiranë dhe me aksionerë: 1) shoqërinë Opportunity Microcredit Fund (Eastern Europe), shoqëri e krijuar në bazë të ligjeve të Anglisë dhe Uellsit, e themeluar më 24 Shkurt 1998 me Numër regjistri 3516266; dhe 2) shoqërinë Opportunity Transformation Investments Inc. shoqëri e krijuar në bazë të ligjeve të Illinois, e themeluar më 19 Qershor 2000.

Më datë 20 maj 2002 është zhvilluar mbledhja e Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve të shoqërisë PARTNERI SHQIPTAR NË MIKROKREDI SHA, e cila ka vendosur: a) Të zmadhojë kapitalin aksioner të shoqërisë PARTNERI SHQIPTAR NË MIKROKREDI SHA duke emetuar 22,022 aksione të reja që i korrespondojnë shumës 220,220,902 lekë, të nënshkruara dhe të shlyera plotësisht me të holla në dorë nga aksionerët:

OPPORTUNITY TRANSFORMATION INVESTMENTS INC ka nënshkruar dhe shlyer 2,078 aksione të reja; dhe

OPPORTUNITY MICROCREDIT FUND (Eastern Europe) ka nënshkruar dhe shlyer 15,015 aksione të reja.

b) Aksionet janë emetuar me vlerën nominale prej ALL 10,000 secili. c) OPPORTUNITY MICROCREDIT FUND (Eastern Europe) do të kontribuojë me 15,015 aksione të reja të zmadhimit total të kapitalit, ndërsa OPPORTUNITY TRANSFORMATION INVESTMENTS INC. do të kontribuojë me 2,078 aksione të reja.

Kapitali aksioner i zmadhuar është shlyer me këste si më poshtë:

1)	31.05.01	169,900 USD	147.52 kursi këmbimit	25,063,647 Lekë
2)	17.07.01	106,000 USD	146.53	15,532,180 Lekë
3)	24.08.01	75,000 USD	141.68	10,626,000 Lekë
4)	03.09.01	75,000 USD	141.29	10,596,750 Lekë
5)	17.09.01	306,000 USD	139.91	42,812,460 Lekë
6)	02.10.01	350,000 USD	139.81	48,933,500 Lekë
7)	31.10.01	129,900 USD	139.22	18,084,678 Lekë
8)	03.12.01	202,900 USD	137.	27,797,300 Lekë
9)	21.12.01	50,000 USD	137.04	6,852,000 Lekë
10)	15.01.02	100,000 USD	140.17	14,017,000 Lekë
Totali:		1,564,700 USD		220,315,516 Lekë
Minus komisionet bankare 675 USD				94,614 Lekë

TOTALI 1,564,025 USD

220,220,902 Lekë

d) Pas zmadhimit të kapitalit aksioner zotërimi i aksioneve do të jetë si më poshtë:

OPPORTUNITY TRANSFORMATION INVESTMENTS INC. zotëron 22,022 aksione ose 53 për qind të kapitalit aksioner; dhe

OPPORTUNITY MICROCREDIT FUND (Eastern Europe) zotëron 19,255 aksione ose 47 për qind të kapitalit aksioner.

Asambleja vendosi të emërojë Z. Stuart White si anëtar të Këshillit Mbikqyrës në vend të Michael Martin, Richard Halmekangas, Robert Baker dhe Roland Bagaviki të cilët shkarkohen nga kjo detyrë,

PËR KËTO ARSYE:

Pas shqyrtimit të kërkesës, e çmoj atë të mbështetur në ligjin Nr. 7638, 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare" dhe Ligjin Nr. 7667, datë 28.01.1993 "Për regjistrin tregtar dhe formalitetet që duhen respektuar nga shoqëritë tregtare",

VENDOSA:

- Pranimin e Kërkesës;
- Depozitimin e Vendimit të Asamblesë së Jashtëzakonshme të shoqërisë PARTNERI SHQIPTAR NË MIKROKREDI SHA të datës 20 maj 2002 për zmadhimin e kapitalit aksioner të shoqërisë me vlerën 1,564,025 USD (një milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e njëzetë e pesë dollarë amerikanë) që i korrespondon vlerës 220,220,902 Lekë (dyqind e njëzetë milionë e dyqind e njëzetë mijë e nëntëqind e dy). Pas zmadhimit të kapitalit aksioner OPPORTUNITY TRANSFORMATION INVESTMENTS INC. zotëron 22,022 aksione ose 53 për qind të kapitalit aksioner; dhe OPPORTUNITY MICROCREDIT FUND (Eastern Europe) zotëron 19,255 aksione ose 47 për qind të kapitalit aksioner.

Asambleja vendosi të emërojë Z. Stuart White si anëtar të Këshillit Mbikqyrës në vend të Michael Martin, Richard Halmekangas, Robert Baker dhe Roland Bagaviki të cilët shkarkohen nga kjo detyrë,

- Urdhërohet zyra e Regjistrat Tregtar të bëjë pasqyrimin e ndryshimeve në skedën përkatëse të shoqërisë.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit.

GJYQTARE

ANILA CAPO

